



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE**

**VENDIM**

**NR. 5, DATË 07 / 05 / 2024**

**PËR MOSPRANIM TË KËRKESËS PËR PËRFITIM TË STATUSIT**  
**“INVESTIM/INVESTITOR STRATEGJIK PROCEDURË E ASISTUAR” PËR**  
**PROJEKTIN E INVESTIMIT “LIVADH BEACH RESORT” ME SUBJEKT**  
**APLIKUES**

**XHELUKS KONSTRUKSION SHPK NUIS L02511411J**

Në mbështetje të Nenit 9, nenit 13, nenit 17 pika 5 të Ligjit Nr. 55/2015, “Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë”, Kreu I, pika 3/c të VKM Nr. 1023, datë 16.12.2015 “Për Nënsektorët Strategjikë dhe Zonat me Përparësi Zhvillimi” dhe Kreut II, pika 8, 10 e VKM Nr. 1026, datë 16.12.2015 “Për vlerësimin e dokumentacionit të investimeve strategjike”, Komiteti i Investimeve Strategjike vlerësoi se:

- Projekti i investimit parashikon ndërtimin e një strukture akomoduese, ku do të ketë një hotel me 60 dhoma, me ambiente shërbimi si bare dhe restorante, ambiente rekreative si pishina, ambiente çlodhjeje, zona të gjelbëruara dhe parkim në Bashkinë Himarë.
- Vlera e investimit për projektin e propozuar parashikohet të jetë 17,800,000 Euro (shtatëmbëdhjetë milion e tetëqind mijë) Euro dhe numri i të punësuarve parashikohet të jetë 80 punonjës.
- Pasuritë e paluajtshme që preken nga projekti i investimit të propozuar zënë një sipërfaqe totale 3,200 m<sup>2</sup>, në ZK Nr. 1952 dhe më konkretisht përbëhen nga pasuritë me nr 1/1811, lloji pasurisë “arë”, pronë shtet, nr. 1/44, lloji pasurisë ‘arë”, pronë private dhe nr. 1/43, lloji pasurisë “arë”, pronë private.
- Projekti realizohet nga subjekti “Xheluks Konstruksion” shpk NUIS L02511411J.

- Për subjektin “Xheluks Konstruktion” shpk është miratuar leje zhvillimi për objektin “Strukturë Hotelerie 1 - 4 kate, me vendndodhje në Livadh, Bashkia Himarë” me vendimin Nr. 17, datë 10.06.2021 të Këshillit Kombëtar të Territorit.

Në përfundim, pasi u njoh me gjithë dokumentacionin e nevojshëm,

## **KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE**

### **VENDOSI:**

1. Mospranimin e kërkesës për përfshirjen e projektit investues “Livadh Beach Resort”, me subjekt investues Xheluks Konstruktion shpk, NUIS L02511411J, ZK 1952, Bashkia Himarë, në procedurën e asistuar dhe mbështetjen që ofron ky status.
2. Projekti i investimit nuk mund të realizohet deri sa të qartësohet dhe plotësohet informacioni i vënë në dispozicion nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Vlorë.
3. Në këtë zonë vazhdon procesi i regjistrimit të Akteve të Marrjes të Tokës në Pronësi / Përdorim (AMTP), në referencë të ligjit nr 20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë" dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, si pasojë nuk ka informacion lidhur me regjistrimin e këtyre AMTP-ve.
4. Vendimi i Komitetit të Investimeve Strategjike publikohet dhe regjistrohet në Regjistrin e Investimeve Strategjike dhe i njoftohet kërkuarit nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, në rolin e saj të Sekretariatit të Komitetit të Investimeve Strategjike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KRYETAR I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE**

### **KRYEMINISTËR**

EDI RAMA

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**  
BELINDA BALLUKU

**MINISTËR I EKONOMISË KULTURËS DHE INOVACIONIT**  
BLENDI GONXHJA

**MINISTËR I FINANCAVE**  
ERVIN METE

**MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT**  
MIRELA KUMBARO

**MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL**  
ANILA DENAJ

**AVOKATI I PËRGJITHSHËM I SHTETIT**  
ODISE MOÇKA

**SEKRETARIATI TEKNIK I KIS**  
**LAURA PLAKU (SARO)**